



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

ADGJA.nr.10/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Kryetari i Gjykatës Valon Totaj, duke vendosur përkitazi me ankesën disiplinore të parashtruar nga L.K, nga F...., komuna e Prizrenit, ndaj gjyqtares të Gjykatës së Apelit të Kosovës, H.P, lidhur me vendosjen në lëndën Ac.nr.5107/2018, të Gjykatës së Apelit në Kosovë, në kuptim të nenit 9, paragrafi 1.1 dhe 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, me datën 28.12.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa disiplinore e parashtruar nga L.K, nga F...., komuna e Prizrenit, ndaj gjyqtares të Gjykatës së Apelit të Kosovës, H.P, lidhur me vendosjen në lëndën Ac.nr.5107/2018, të Gjykatës së Apelit në Kosovë.

A r s y e t i m

Me datën 21.12.2023, nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), Gjykata e Apelit e Kosovës, e ka pranuar ankesën e L.K, nga Prizreni. Në ankesë i njëjti ka pretenduar se gjyqtarja H.P pa u bazuar në ankesën e tij të afatshme dhe të paraqitur me dëshmi e fakte reale, e thotë të pavërtetën se ankuesi nuk ka dorëzuar dokument, me të cilin do të arsyetohet se i njëjti nuk ka pronë dhe i njëjti pronën e ka shitur. Tutje ka theksuar se si është e mundur që i njëjti të ketë shitur pronën e cila nuk është në emër të tij edhe gjyqtarja në fjalë e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e L.K, ndërsa aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren PPP.nr.267/17, të datës 22.10.2018, e ka vërtetuar, më detalisht sikurse në ankesën e tij.

Kryetari i Gjykatës, pas pranimit dhe vlerësimit të ankesës, me datë 26.12.2023, nga gjyqtarja e Gjykatës së Apelit të Kosovës, në lëndën Ac.nr.5107/2018, ka kërkuar deklaram lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesi L.K.

Gjyqtarja H.P, ka dhënë deklaratë me datën 27.12.2023, ku ka theksuar se pretendimet e ankuesit janë të pabazuara pasi që në çështjen konkrete përmbarimore ka vendosur në bazë të provave shkresore, nga të cilat ka rezultuar se pretendimet e ankuesit janë të pabazuara, andaj në këtë drejtim ka dhënë edhe arsyet e përshkruara si në aktvendimin e referuar. Tutje ka theksuar se si rregull, si gjyqtare e çështjes, nuk ka autorizime ligjore për t'i komentuar vendimet apo për të dhënë arsye shtesë nga ato të paraqitura në aktvendim. Gjithashtu ka theksuar se nëse pala ankuese në kohën e pranimit të aktvendimit, ka vlerësuar se ka bazë të mjaftueshme për të kërkuar shqyrtim të ligjshmërisë së aktvendimit, eventualisht ka mundur që çështjen ta adresojë më prokurorinë kompetente, në mënyrë që të mund të vlerësohet nëse ekziston bazë e mjaftueshme që të ushtrohet mjet i jashtëzakonshëm juridik, respektivisht kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, pasi që në këtë rast nga gjykata tjetër do të mund të vlerësohej ligjshmëria e atij aktvendimi, më detalisht sikurse në deklaratën e saj.

Kryetari i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, vlerësimit të pretendimeve ankimore dhe deklaratës së gjyqtarës H.P, ka gjetur se:

- ankesa e ankuesit L.K, është **e pabazuar**.

Kryetari i Gjykatës, pas shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga ankuesi si dhe deklaratave të gjyqtarëve, vlerësoi se pretendimet ankimore sa i përket mënyrës së vendosjes, janë pretendime të pabazuara dhe të paqëndrueshme, për faktin se gjyqtarët janë të pavarur në vendimmarrje, pavarësi kjo e cila i'u është garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Po ashtu gjyqtarët janë të pavarur në punë e tyre, vendosin sipas ligjit dhe vendimet merren në bazë të provave që shqyrtohen dhe verifikohen në shqyrtim kryesor. Sipas vlerësimit të kryetarit, pavarësia individuale, është pavarësia e gjyqtarëve në kryerjen e funksionit të tyre gjyqësor, që nënkupton se gjyqtarët duhet të jenë meritore, objektiv, neutral dhe të liruar nga çdo ndjenjë e ndikimit kur ushtrojnë funksionin e tyre gjyqësor.

Lidhur me pavarësinë në vendimmarrje nuk duhet të ketë asnjë ndërhyrje të pavend apo të pajustificuar në procesin gjyqësor dhe nuk duhet që vendimet gjyqësore të gjykatave t'i nënshtrihen ndryshimit. Në rastin konkret Kryetari i Gjykatës nuk ka kompetencë që të ndryshojë vendimet gjyqësore të nxjerra nga gjyqtari apo kolegji i gjyqtarëve dhe se pala e pakënaqur ndaj aktgjykimit të Gjykatës së Apelit nëse vlerëson se vendimi është marrë në kundërshtim me dispozitat kushtetuese, i njëjti eventualisht mund të parashtrijë kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, ndërsa nëse vlerëson se ka baza të tjera ankimore, atëherë i njëjti eventualisht mund t'i drejtohet Gjykatës Supreme.

Kryetari i Gjykatës vlerësoi, se në rrethanat aktuale të çështjes nuk ka bazë për të hapur një hetim disiplinor lidhur me vendosjen e çështjes së parashtruesit të ankesës, meqë me prova të shqyrtuara nuk është vërtetuar se gjyqtarja H.P ka bërë shkelje të Kodit të Etikës.

Ndërkaq, për punën profesionale të gjyqtarit apo kolegjit, kompetent për vlerësim profesional është Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve i cili vepron në kuadër të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës, ku i njëjti bën vlerësimin e performancës për gjyqtarët.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit në kuptim të nenit 9, paragrafi 1, pika 1.1. të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokurorëve.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
ADGJA.nr.10/2023, me datë 28.12.2023

Kryetari i Gjykatës
Valon Totaj

Vendimi t'i dorëzohet:

- Parashtruesit të ankesës,
- Gjyqtares H.P
- Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
- Një kopje në shkresa të lëndës,